

LAETITIA COLOMBANI
GËRSHETI
ROMAN

BOTIMET TOENA

Autori: Laetitia Colombani (Leticia Kolombani)

Titulli në origjinal: La tresse

Botoi në frëngjisht: Les Éditions Grasset & Fasquelle

Me mbështetjen e Programit
"Europa Krijuese"
të Komisionit Europian



Me bashkëfincimin e Programit

"Europa Krijuese" të Bashkimit Europian .

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktore: Besa Vila

Korrektore letrare: Majlinda Bami

Përkujdesja grafike: Elsa Hajderaj

Kopertina: Mirjana Madhi

© e kopertinës: Livia Stavri

ISBN 978-9928-277-99-2

© Les Éditions Grasset & Fasquelle, 2017

© në shqip Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: redaksia@toena.com.al

botimet.toena@gmail.com

www.toena.com.al

LAETITIA COLOMBANI

GËRSHETI

roman

Përktheu nga origjinali frëngjisht
Blerta Hyska

BOTIMET TOENA
Tiranë, 2020

Për Olivian

Për gratë e guximshme

Gërshet e.m.- tufë flokësh thurur bisht,
nga ndërthurja e tri tufëzave.

*... Simonë, ka një mister të madh në pyllin
e flokëve të tu.*

Remi de Gurmo

*Një grua e lirë është absolutisht e kundërta e një
gruaje të lehtë.*

Simonë dë Bovuar

PROLOG

*Është fillimi i një historie.
Një historie të re çdo herë.
Po merr jetë tani, nën gishtat e mi.*

*Në fillim, skeleti.
Struktura duhet të jetë mjaft e fortë për të mbajtur të
tërën.
Mëndafsh apo pambuk, për jetën e përditshme apo
skenën. Gjithçka varet.
Pambuku është më i qëndrueshëm.
Mëndafshi më i hollë dhe më fin.
Duhet një çekiç dhe gozhdë.
Mbi të gjitha, duhet bërë me kujdes.*

*Pastaj vjen endja.
Është pjesa që pëlqej.
Në veglën para meje
Tri fije najloni tendosur.
Kap fijet, në turrë, tri nga tri,
I lidh pa i këputur.
Pastaj fillon përsëri,
Me mijëra herë.*

*I dua këto orë vetmitare, kur duart e mia vallëzojnë.
Balet i çuditshëm i gishtave të mi.
Ata shkruajnë një histori gërsheti dhe thurjeje.
Kjo histori është imja.*

E megjithatë, nuk më përket mua.

Smita

Fshati Badlapur, Uttar Pradesh, Indi

Smita zgjohet me një ndjesi të çuditshme, një ngut i ëmbël, një flutur e pazakontë në bark. Sot është një ditë që ajo do ta mbajë mend gjithë jetën. Sot, vajza e saj do të shkojë në shkollë.

Smita, në shkollë, nuk ka shkelur kurrë. Këtu në Badlapur, njerëzit si ajo nuk shkojnë. Smita është Dalit. E Papranuar. Nga ata që Gandhi i quante fëmijët e Zotit. Jashtë kaste, jashtë sistemi, jashtë gjithçkaje. Një specie më vete, e gjykuar shumë e pistë për t'u përzier me të tjerët, një rreckë e pavlefshme, që e largojnë sikurse ndajnë farën e mirë nga egjra. Si Smita, ata janë me mijëra që jetojnë jashtë fshatrave, shoqërisë, në periferi të njerëzimit.

Çdo mëngjes, është i njëjti ritual. Si një disk i prishur, që luan pambarimisht një simfoni të tmerrshme, Smita zgjohet në kasollen që i shërben si shtëpi pranë fushave

të mbjella të Jatts-ve. Ajo lan fytyrën dhe këmbët me ujin e sjellë një natë më parë nga pusi, uji i rezervuar për ta. Nuk duhet prekur në asnjë mënyrë tjetri, ai i kastave të larta, edhe pse më afër dhe i gjindshëm. Disa kanë vdekur për më pak se kaq. Ajo bëhet gati, i kreh flokët Lalitës, përqafon Nagarajanin. Pastaj merr shportën prej kulmaku të thurur, këtë shportë që merrte e ëma para saj dhe që ia sjell zorrët te goja vetëm duke e parë; këtë shportë me erë të fortë, të athët, dhe të paheqshme, që ajo e mban gjithë ditën siç mbahet një kryq, një barrë e turpshme. Kjo shportë është kalvari i saj. Një mallkim. Një dënim. Diçka, që ajo mund ta ketë bërë në një jetë të mëparshme, duhet paguar, vuajtur, në fund të fundit kjo jetë nuk ka më shumë rëndësi sesa të mëparshmet apo të ardhshmet, është thjesht një jetë ndër jetët e tjera, thoshte e ëma. Kështu është, është jeta e saj.

Është *darma* e saj, detyra e saj, vendi i saj në botë. Një zanat që transmetohet nga nëna te bija, prej brezash. *Scavenger*, në anglisht do të thotë “nxjerrës”. Një fjalë e thjeshtë për të përshkruar një realitet që nuk është i tillë. Ajo që bën Smita nuk ka fjalë për ta përshkruar. Ajo mbledh me duar jashtëqitjet e të tjerëve, gjithë ditën. Ishte gjashtë vjeçe, mosha që ka Lalita sot, kur e ëma e mori me vete për herë të parë. Shiko, pastaj do ta bësh ti. Smita mban mend erën që e sulmoi, dhunshëm si një fole grezësh, një erë e padurueshme, jonjerëzore. Ajo kishte vjellë anash rrugës. Do të mësohesh, i kishte thënë

e ëma. Ajo e kishte gënjyer. Nuk mësohesh. Smita kishte mësuar si të mbante frymën, të jetonte pa të, duhet të marrësh frymë, kishte thënë doktori i fshatit, pa shikoni si kolliteni. Duhet të hash. Oreksin Smita e ka humbur prej kohësh. Ajo e ka harruar si është të kesh uri. Ajo ha pak, minimumin e nevojshëm, një grusht oriz të shkrirë në ujë, e ha me detyrim, si përdhunë ndaj trupit të saj.

Qeveria kishte premtuar tualete për të gjithë vendin. Për fat të keq, nuk mbërritën deri këtu. Në Badlapur, si kudo, jashtëqitja kryhet në qiell të hapur. Kudo toka është e ndotur, ujërat, lumenjtë, fushat janë të fëlliqura nga tonë jashtëqitjeje. Sëmundjet përhapen si shkëndija në barut. Politikanët e dinë: ajo që kërkon populli, më shumë se reformat, më shumë se barazia sociale, madje më shumë se puna, janë tualetet. E drejta për të kryer nevojat me dinjitet. Nëpër fshatra gratë janë të detyruara të presin sa të bjerë nata për të shkuar në fusha, duke rrezikuar veten nga sulmet e ndryshme. Ata më me fat kanë sajuar një qoshe në oborr ose në fund të shtëpisë, një vrimë të thjeshtë, që e quajnë me turp “tualet i thatë”, nevojtoje që gratë Dalit vijnë çdo mëngjes për ta zbrazur duke futur duart e tyre. Gra si Smita.

Dita e saj e punës fillon rreth orës shtatë. Smita merr shportën dhe fshesën prej kulmaku. Ajo e di se duhet të zbrazë njëzet shtëpi çdo ditë, nuk ka kohë për të humbur.

Ajo ecën anash rrugës, me sy të ulur, fytyrën fshehur nën një shall. Në disa fshatra, Dalitët duhet të njoftojnë praninë e tyre duke mbajtur një pendë korbi. Në disa të tjera, janë të dënuar të ecin këmbëzbathur - të gjithë e njohin historinë e një të Papranuari, i vrarë me gurë vetëm sepse kishte mbathur sandale. Smita hyn në shtëpitë e tyre nga porta e pasme, e lënë për të; ajo nuk duhet të ndeshë banorët, aq më pak t’iu flasë. Ajo nuk është vetëm e Papranuar, duhet të bëhet edhe e padukshme. Në vend të pagës ajo merr mbetje ushqimesh, ndonjëherë rroba të vjetra që ia hedhin në tokë. As prekje, as vështrim.

Ka raste kur nuk merr asgjë fare. Një familje Jatts nuk i jep më asgjë prej muajsh. Smita deshi ta linte, ia tha këtë një mbrëmje Nagarajanit, ajo nuk do të shkonte më atje, le ta pastronin vetë mutin e tyre. Por Nagarajani u tremb: sikur Smita të mos shkonte më, ata do t’i dëbonin, nuk kanë tokë të tyren. Jatts-ët do t’u digjnin kasollen. Ajo e di se ç’janë në gjendje të bëjnë ata. “Do të t’i presim të dyja këmbët”, i kishin thënë një Daliti. Dhe e gjetën burrin pa këmbë dhe të djegur me acid në fushën aty afër.

Po, Smita e di çfarë janë të aftë të bëjnë ata.

Atëherë, ajo kthehet përsëri të nesërmen.

Por sot nuk është një ditë si të tjerat. Smita ka marrë një vendim, që i erdhi vetvetiu si gjëja e duhur për t’u bërë: vajza e saj do të shkojë në shkollë. Ajo e pati të

vështirë të bindë Nagarajanin. E përse duhet? Thoshte ai. Ndoshta do të mësojë të lexojë dhe të shkruajë, por këtu askush nuk do t'i japë punë. Lind pastruese nevojtoresh dhe mbetesh kështu deri në fund të jetës. Është një trashëgimi, një rreth nga i cili askush nuk mund të dalë. Një *karma*.

Smita nuk u dorëzua. Ajo i foli përsëri të nesërmen, të pasnesërmen, ditëve në vijim. Ajo nuk pranon ta marrë Lalitën me vete në punë: nuk do t'i tregojë asaj gjestet e zbrazësve të nevojtoreve, nuk do ta shohë të bijën të vjellë në një hendek, ashtu si ka vjellë ajo vetë, kur shihte të ëmën që bënte po të njëjtën punë. Jo, Smita refuzon. Lalita duhet të shkojë në shkollë. Përballë vendosmërisë së saj, Nagarajani më në fund u dorëzua. Ai e njeh të shoqen; vullneti i saj është i fortë. Kjo Dalite e vogël, me lëkurë të zeshkët, të cilën e mori për grua para dhjetë vjetësh, është më e fortë se ai dhe ai e di. Atëherë u dorëzua. Ashtu u bëftë. Ai do të shkojë në shkollën e fshatit e do të flasë me Brahmanin.

Smita buzëqeshi fshehtas për fitoren e saj. Ajo do të kishte dashur kaq shumë që e ëma të luftonte për të, do të kishte dëshiruar kaq shumë të kapërcente pragun e shkollës, të ulej me fëmijët e tjerë. Të mësonte të lexonte dhe të numëronte. Por kjo nuk kishte qenë e mundur, babai i Smitës nuk ishte një njeri i mirë si Nagarajani, ai

ishte inatçi dhe i dhunshëm. E rrihte të shoqen, si gjithë të tjerët këtu. Dhe përsëriste shpesh: një grua nuk është e barabartë me burrin e saj, ajo i përket atij. Është prona e tij, skllavja e tij. Ajo duhet t'i përulet vullnetit të tij. Me siguri, i ati më parë shpëtonte lopën sesa gruan e tij.

Smita ka pasur fat: Nagarajani nuk e ka rrahur kurrë, nuk e ka fyer kurrë. Kur lindi Lalita, ai ishte dakord për ta mbajtur. Jo shumë larg prej këtu, vajzat i vrasin që në lindje. Në fshatrat e Raxhastanit, i varrosin të gjalla, në një kuti, nën rërë, menjëherë sapo lindin. Vajzat e vogla vuajnë një natë të tërë derisa vdesin.

Por jo këtu. Smita kundron Lalitën, të ulur në bisht në truallin prej balte të kasolles, duke krehur kukullën e saj të vetme. Është e bukur, vajza e saj. I ka tiparet fine, flokët e gjatë deri në bel, që Smita ia kreh dhe ia thur gërshet çdo mëngjes.

Ime bijë do të dijë të lexojë dhe të shkruajë, thotë me vete ajo, dhe ky mendim e mbush me gëzim.

Po, sot është një ditë që ajo do ta mbajë mend gjithë jetën.

Xhulia

Palermo, Sicili

Xhulia!

Xhulia hap sytë me mundim. Zëri i së ëmës kumbon që nga poshtë.

Xhulia!

Scendi!

Subito!

Xhulia donte ta fuste kokën nën jastëk. Nuk ka fjetur mjaftueshëm - edhe këtë natë e ka kaluar duke lexuar. E megjithatë ajo e di që duhet të çohet. Kur mamaja thërret, duhet të bindesh - është mama siciliane.

Xhulia!

Vajza lë shtratin me keqardhje. Ajo çohet dhe vishet me nxitim, pastaj zbret në kuzhinë ku mezi po pret

mamaja. E motra, Adela, është çuar tashmë e zënë me pedikyrin e thonjve, me këmbët mbi tryezën e mëngjesit. Aroma e diluentit e bën Xhulian të ngërdheshet. E ëma i sjell një filxhan kafe.

Yt atë doli.

Do ta hapësh ti sot në mëngjes.

Xhulia merr çelësat e punishtes dhe largohet me shpejtësi nga shtëpia.

Nuk vure asgjë në gojë.

Merr diçka me vete!

Pa ua vënë veshin fjalëve të së ëmës, ajo i hipën biçikletës dhe largohet duke pedaluar fort. Ajri i freskët i mëngjesit e zgjon disi. Era e shëtitoreve i fshikullon fytyrën dhe sytë. Pranë tregut, aromat e agrumeve dhe ullinjve ia shpojnë hundën. Xhulia kalon pranë tezgës së peshkatarit që ka nxjerrë sardele dhe ngjala të sapopeshkuara. Ajo rrit shpejtësinë, ngjitet në trotuare, lë sheshin “Ballaro”, ku shitësit ambulante ftojnë ndërkohë klientët.

Ajo mbërrin në një rrugicë qorre, në cep të “Via Roma”-s. Këtu është vendosur punishtja e babait të saj, në një kinema të vjetër, muret e së cilës ai i bleu para

njëzet vjetësh - mosha e Xhulias. Ambientet e saj ishin në atë kohë të ngushta; duhej shkuar diku tjetër. Mbi ballinë, mund të dallohet ende vendi ku vendoseshin afishet e filmave. Është e largët koha kur palermitanët shtyheshin për të parë komeditë e Alberto Sordit, Vittorio Gasmanit, Nino Manfredit, Ugo Tonjacet, Marçelo Mastrojanit... Sot, shumica e sallave janë mbyllur, sikurse kjo kinema e vogël lagjeje e shndërruar në punishte. U desh të shndërrohej kabina e projeksionit në zyrë, të hapeshin dritare në sallën e madhe me qëllim që punëtorët të kishin mjaftueshëm dritë për të punuar. Babai i bëri vetë të gjitha punimet. Ky vend i ngjan atij, mendon Xhulia: është i rrëmujshëm dhe i dashur, si ai. Me gjithë zemërimet e tij legjendare, Pietro Lanfredi çmohet dhe respektohet nga punonjëset e tij. Është një baba i dashur, edhe pse kërkues dhe autoritar, që i ka rritur të bijat me respektin për disiplinën dhe u ka dhënë dëshirën për të bërë punën mirë.

Xhulia kap çelësin dhe hap derën. Zakonisht, i ati mbërrin i pari. Ai do t'i presë vetë punëtorët e tij - kështu është kur je *padrone*, përsërit ai me qejf. Ka gjithmonë një fjalë të mirë për njërën, një përkujdesje për një tjetër, një gjest për secilën. Por sot, ai ka shkuar nëpër floktarët e Palermos dhe në zonën përreth. Nuk do të kthehet para drekës. Këtë mëngjes Xhulia është zonjë shtëpie.

Në këtë orë, gjithçka është e qetë në punishte. Shumë shpejt, ky vend do të gumëzhijë nga mijëra biseda, këngë, zëra të lartë, por për momentin është vetëm heshtja dhe jehona e hapave të Xhulias. Ajo ecën deri te dhoma e veshjes së punonjësve, dhe vendos gjërat e saj në një kuti me emrin e saj. Merr një bluzë, rrëshqet si çdo ditë në këtë lëkurë të dytë. Ajo mbledh flokët, i rrotullon në një topuz të shtrënguar dhe vendos disa kapëse me shkathtësi. Pastaj mbulon kokën me një shami, masë e domosdoshme këtu - nuk duhet të përzihen flokët e tyre me ato që trajtohen në punishte. E veshur dhe e mbuluar në këtë mënyrë, ajo nuk është më vajza e pronarit: është një punonjëse si gjithë të tjerat, një e punësuar e ndërmarrjes Lanfredi. Ajo e do vetë këtë. Nuk ka pranuar asnjëherë të jetë e privilegjuar.

Dera hapet me një gërvimë, dhe një valë e gëzueshme mbush hapësirën. Në një çast, punishtja u gjallërua, u bë ai vendi i zhurmshëm që Xhulia e donte aq shumë. Në një zhurmënjë të padallueshme, ku bisedat ngatërrohen, punëtoret nxitojnë për në dhomën e veshjes, ku veshin bluza dhe përparëse, pastaj zënë vendin e tyre duke bërë muhabet. Xhulia bashkohet me to. Anjeza e ka fytyrën të hequr - të voglit të saj po i dalin dhëmbët, ajo nuk ka vënë gjumë në sy. Federika mban lotët, i fejuari e ka lënë. Prapë?! - habitet Alda. Do të kthehet nesër, e qetëson Paola. Këtu gratë ndajnë më tepër së të njëjtin zanat. Ndërsa duart e tyre punojnë flokët, ato flasin për burrat,

për jetën, për dashurinë, gjatë gjithë ditës. Këtu të gjitha e dinë që burri i Xhinës pi, që djali i Aldës ngatërrohet me *Piovra*-n, që Alesia ka pasur një lidhje të shkurtër me ish-burrin e Rinës, që kjo e fundit nuk ia fali kurrë.

Xhulias i pëlqen shoqëria e këtyre grave, disa prej të cilave e njohin që fëmijë. Ajo thaujse ka lindur këtu. E ëma tregon se si e kapën dhimbjet në kohën kur ishte duke ndarë flokët në sallën kryesore - ajo nuk punon më tani për shkak të dobësimit të shikimit; iu desh t'ia linte vendin një punonjëseje me sy më të mprehtë. Xhulia u rrit aty, mes flokëve që duheshin shpleksur, tufave që duheshin larë, porosive që duheshin dërguar. Ajo mban mend pushimet dhe të mërkurat që ka kaluar me punëtoret, i shihte teksa punonin. Asaj i pëlqente të vështronte duart e tyre kur lëviznin si ushtri milingonash. I shihte të hidhnin flokët mbi gjembat, mbi ata krehtrat e mëdhenj katrorë, për t'i shpleksur, pastaj i lanin në vaskën e vendosur mbi këmbalecë - një sajesë e gjetur prej babait të saj, i cili nuk donte që punonjësve të tij t'u lodhej kurrizi.

Xhulia qeshte me mënyrën se si vareshin tufat e flokëve në dritare për t'u tharë - sikur të ishte plaçka e luftës e një fisi indian, një radhë skalpesh të ekspozuara në mënyrë të çuditshme.

Ndonjëherë Xhulias i duket sikur koha ka ndalur. Ajo vazhdon vrapin e saj jashtë, por brenda këtyre mureve

ndihet e mbrojtur. Është një ndjesi e ëmbël, qetësuese, siguria e një përjetshmërie të çuditshme të gjërave.

Ka pothuaj një shekull që familja e saj nxjerr jetesën prej *casatura-s*, traditë e vjetër siciliane e mbledhjes së flokëve që priten për t'i bërë parukë ose flokë të rremë. E themeluar në vitin 1926, nga stërgjyshi i Xhulias, punishtja Lanfredi është e fundit e këtij lloji në Palermo. Ajo numëron rreth dhjetë punëtore të specializuara, që shpleksin, lajnë dhe trajtojnë tufa flokësh, të cilat më pas dërgohen në Itali dhe në gjithë Europën. Ditën kur mbushi gjashtëmbëdhjetë vjeçe, Xhulia vendosi të lërë gjimnazin për të hyrë në punishten e të atit. Nxënëse e talentuar, sipas mësuesve të saj, sidomos mësuesit të italishtes, që e nxiste të vazhdonte, ajo mund të kishte kryer studimet, të kishte hyrë në universitet. Por për atë as që bëhej fjalë të merrte rrugë tjetër. Më tepër se traditë, flokët janë pasion për familjen Lanfredi, që transmetohet nga brezi në brez.

Çuditërisht, motrat e Xhulias nuk shfaqën interes për këtë zanat, ndërsa ajo është e vetmja ndër motrat Lanfredi që i është përkushtuar. Françeska u martua e vogël, dhe nuk punon; ajo ka katër fëmijë sot. Adela, e vogla, është ende në gjimnaz dhe do të vazhdojë me modën ose si modele, - gjithçka tjetër, veç rrugën e prindërve jo.

Për porositë e specializuara, ngjyrat e vështira për t'u gjendur, babai ka një sekret: një formulë të trashëguar nga i ati dhe i gjyshi para tij, e përbërë nga produkte natyrore që ai nuk i tregon kurrë. Këtë formulë ai ia ka transmetuar Xhulias. Ai e merr shpesh mbi çati, në *laboratorio*-n sikurse e quan ai. Prej aty lart shihet deti dhe nga ana tjetër Monte Pelegrino. I veshur me një përparëse të bardhë, që e bën të ngjajë si profesor kimie, Pietro bën të vlojnë kazanë të mëdhenj, te të cilët do të kryejë lyerjen: ai di si t'ua heqë bojën flokëve dhe t'i lyejë përsëri, pa e humbur ngjyrën gjatë larjes. Xhulia e shikon si e bën, për orë të tëra, e vëmendshme ndaj lëvizjeve më të vogla të tij. Babai i saj u rri mbi kokë flokëve ashtu si mamaja kur gatuan makaronat. Ai i trazon me një lugë druri, i lë të pushojnë, pastaj u kthehet përsëri pa u lodhur me durim, rreptësi, dashuri gjithashtu; ky është kujdesi i tij për flokët. Ai thotë se një ditë këta flokë do t'i mbajnë dikush dhe meritojnë respektin më të madh. Ndonjëherë Xhulias i shkon mendja te gratë që do t'i mbajnë këto parukë - burrat e këtushëm nuk mbajnë nga këto gjëra, janë shumë krenarë, shumë të lidhur pas njëfarë ideje të burrërisë.

Për një arsye të panjohur, disa flokë i rezistojnë formulës sekrete të Lanfredëve. Nga kazanët ku janë zhytur, shumica dalin të bardha si qumësht, çka bën të lyhen më pas, por disa prej tyre ruajnë ngjyrën origjinale. Këto fije rebele

janë një problem i vërtetë: as nuk mendohet që një klient të gjejë, në mes të një tufe flokësh të lyer me kujdes, fije të pabindura të zeza ose kafe.

Për shkak të mprehtësisë së shikimit, Xhulia ka këtë detyrë delikate: duhet të ndajë flokët një për një, me qëllim që të nxjerrë të pandreqshmet. Është një gjueti e vërtetë shtrigash, një kërkim i imët, i vazhdueshëm që ajo e kryen çdo ditë.

Zëri i Paolas e nxjerr nga ëndërrimet.

Mia cara, dukesh e lodhur.

Ke lexuar prapë gjithë natën.

Xhulia nuk e mohon. Paolas nuk mund t'i fshehësh asgjë. Gruaja e moshuar është veterania e punëtoreve të ateliesë. Këtu, të gjitha e quajnë *Nonna*. Ajo e ka njohur babanë e Xhulias që fëmijë; Paola tregon se i lidhte atij këpucët. Sipër shtatëdhjetë e pesë vjetëve të saj, ajo sheh gjithçka. Duart e saj janë të ngrëna, lëkura e rrudhur si pergamenë, por shikimi gjithmonë depërtues. Vejushë në moshën njëzetepesëvjeçare, ajo i ka rritur e vetme të katër fëmijët e saj, duke mos pranuar të martohej më kurrë.

Kur e pyesin përse, ajo përgjigjet se e ka shumë të shenjtë lirinë e saj: “Një grua e martuar duhet të japë llogari, - thotë ajo. - Bëj çfarë të duash, *mia cara*, por ama

mos u marro”, e porositi Xhulian. Ajo tregon me dëshirë fejesën e saj më burrin që ia kishte gjetur i ati. Familja e burrit të saj të ardhshëm kishte një fermë me limonë. *Nonna* kishte punuar për mbledhjen e tyre edhe ditën e dasmës së saj. Në fshatra nuk ka kohë për të pushuar. Ajo mban mend aromën e limonit që nuk i ndahej veshjeve dhe duarve të të shoqit. Kur ai vdiq nga pneumonia disa vite më vonë, duke e lënë vetëm me katër fëmijë, asaj iu desh të shkonte në qytet për të gjetur një punë. Aty takoi gjyshin e Xhulias, që e punësoi në punishte. Tanimë bëhen pesëdhjetë vjet që ajo punon aty.

Nuk do ta gjesh burrin nëpër libra! Këlthet Alda.

Lëre të qetë me këtë histori, e qorton *Nonna*.

Xhulia nuk kërkon burrë. Ajo nuk shkon as në kafe, as nëpër klubet e natës, të pëlqyera nga moshatarët e saj. “Ime bijë është pak e egër”, e ka për zakon të thotë mamaja. Më tepër sesa rrëmujën e diskotekave, Xhulia pëlqen qetësinë e bibliotekës së qytetit. Ajo shkon atje çdo ditë në kohën e drekës. Lexuese e pangopur, i pëlqen atmosfera e sallave të mëdha, të veshura me libra që vetëm fëshfërima e faqeve u prish qetësinë. Asaj i duket sikur ka diçka fetare, një meditim pothuaj mistik që i pëlqen. Kur lexon, Xhulia nuk e kupton si ikën koha. E vogël ajo përpinte romanet e Emilio Salgarit, e ulur në këmbët e punëtorëve. Më vonë, zbuloi poezinë. Ajo pëlqen Kapronin më shumë se Ungaretin, prozën e Moravias dhe sidomos fjalët e Pavezës; shkrimtari i saj i

preferuar. Ajo mendon se mund ta kalonte gjithë jetën e saj vetëm në shoqërinë e tij. Harron edhe të hajë. Ndodh shpesh të kthehet me barkun bosh nga pushimi i drekës. Ja që kështu është: Xhulia i përpin librat me aq uri sa dhe njerëzit e tjerë *cannoli*-t.

Kur kthehet në punishte atë pasdite, një heshtje e pazakontë mbretëron në sallën kryesore. Kur hyn, të gjitha vështrimet kthehen nga Xhulia.

Cara mia, i thotë *Nonna*, me një zë që ajo nuk ia ka dëgjuar më parë, mamaja sapo mori në telefon.

Diçka i ka ndodhur babait.

Sara

Monreal, Kanada

Bie zilja e zgjimit dhe numërimi mbrapsht fillon. Sara lufton kundër kohës, nga çasti kur çohet deri tek ai kur bie për të fjetur. Në sekondën kur hap sytë, truri i saj ndizet si një procesor kompjuteri.

Çdo mëngjes ajo zgjohet në orën pesë. Nuk ka kohë të flejë më tepër, çdo sekondë vlen. Dita e saj është e kronometruar, milimetruar si ato fletët që ajo blen në fillim të shkollës për mësimet e matematikës së fëmijëve. Është larg koha e moskokëçarjeve, ajo para studios, mëmësisë, përgjegjësi. Në atë kohë mjaftonte një telefonatë për të ndryshuar rrjedhën e ditës: po sikur sot në mbrëmje?... Po sikur të nisemi?... Po sikur të shkojmë?... Sot gjithçka është e planifikuar, e organizuar, e paraprirë. S'ka më improvizime, roli është mësuar, luajtur, përsëritur çdo ditë, çdo javë, çdo muaj, gjithë vitin. Kryefamiljare, kuadër i lartë, *working-girl*, *it-girl*, *wonder-woman*,

gjithë këto etiketa që revistat femërore u ngjitin në kurriz grave si ajo, si çanta që varen në supet e tyre.

Sara çohet, bën dush, vishet. Gjestet e saj janë të sakta, efikase, të orkestruara si një simfoni ushtarake. Ajo zbret në kuzhinë, shtron tryezën për mëngjesin, gjithmonë në të njëjtën radhë: qumësht, tasa, lëng portokalli, kakao, kek për Hanën dhe Simonin, drithëra për Etanin, kafe dopio për veten. Pastaj shkon të zgjojë fëmijët, Hanën në fillim, pastaj binjakët. Rrobat e tyre i ka përgatitur Roni një natë më parë, ata vetëm duhet të lajnë fytyrën dhe t'i veshin, ndërsa Hana mbush *lunchboxes*-et, është një skemë që ecën, po aq shpejt sa edhe *Berlina* e Sarës në rrugët e qytetit, për t'i çuar në shkollë; Simoni dhe Etani në fillore, Hana në kolegji.

Pas të puthurave dhe “nuk ke harruar gjë, mbulohu mirë, suksese në provimin e matematikës, mjaft u ngacmuat aty mbrapa, jo, do të shkosh në palestër, - dhe më në fund fjalja tradicionale, - fundjavën që vjen jeni me baballarët tuaj”. Sara merr drejtimin për në studio.

Në orën tetë e njëzet saktësisht, ajo parkon makinën para tabelës me emrin e saj: “*Sara Kohen, Johnson & Lockwood*”. Kjo pllakë, që ajo e kundron çdo mëngjes me krenari, tregon më tepër se një vend për makinën e saj; ajo është një titull, një gradë, vendi i saj në botë. Një realizim, puna e një jete. Suksesi i saj, territori i saj.

Në holl, portieri e përshëndet, pastaj recepsionistja, gjithmonë sipas të njëjtit ritual. Këtu të gjithë e vlerësojnë. Sara hyn në ashensor, shtyp butonin e katit të 8-të, kalon korridoret me hap të shpejtë në drejtim të zyrës. Nuk ka shumë njerëz, shpesh ajo vjen e para dhe ikën e fundit. Ky është çmimi për të ndërtuar një karrierë, ky është çmimi për t'u bërë Sara Kohen, ortak *i barabartë* i studios prestigjioze të avokatisë *Johnson & Lockwood*, një nga më të njohurat në qytet. Edhe pse gratë, që punojnë këtu, *përbëjnë* shumicën, Sara është e para që u ngrit në rangun e ortakes, në këtë studio të njohur si maskiliste. Shumica e shoqeve të saj të shkollës së avokatisë u përplasën me tavanin e qelqtë¹. Disa madje e braktisën profesionin, ndryshuan karrierë, edhe pse kishin kryer studime të gjata dhe kërkuese. Por jo ajo. Jo Sara Kohen. Tavanin ajo e bëri thërmija, e shpërtheu duke e goditur me orë shtesë, me fundjava të kaluara në zyrë, me net duke përgatitur mbrojtjen. Asaj i kujtohet hera e parë kur hyri në hollin e madh prej mermeri, dhjetë vjet të shkuara, për intervistën e saj të punës. U gjend para tetë burrave, një prej të cilëve Xhonsoni dora vetë, ortaku themelues, *Managing Partner*, zoti vetë. Kishte dalë nga zyra për atë rast dhe kishte zbritur në sallën e mbledhjeve.

¹ Nga anglishtja glass ceiling, shprehje e shfaqur në SHBA në vitet 1970. Tregon faktin që në një strukturë hierarkike nivelet më të larta nuk janë të mundshme për disa kategori personash, këtu gratë (shën. i përkth.).

Ai nuk kishte thënë asnjë fjalë, e kishte parë me një vështrim të sertë, kishte zhbirilluar çdo rresht të CV-së së saj pa komentim më të vogël. Sara ishte ndier e hutuar, por kish ditur ta fshihte se ajo ishte eksperte në artin e mbajtjes së maskës, një disiplinë që e praktikonte prej kohësh. Kur kishte dalë ishte ndier disi e shkurajuar sepse Xhonsoni nuk kishte shfaqur asnjë interes ndaj saj, nuk i kishte bërë asnjë pyetje. Si një lojtar i thekur gjatë një loje pokeri, ai kishte ruajtur gjatë gjithë intervistës një shprehje fytyre të paluhatshme, kishte denjuar një “mirupafshim” të thatë që nuk linte shumë shpresë për të ardhmen. Sara e dinte se kishte shumë kandidatë për këtë vend. Ajo vinte nga një studio tjetër, më e vogël dhe më pak prestigjioze, nuk ishte e sigurt nëse do ta pranonin. Të tjerët kishin më shumë përvoja, më shumë agresivitet, ndoshta më shumë fat, gjithashtu.

Më vonë ajo kishte marrë vesh që Xhonsoni e kishte zgjedhur vetë, e kishte piketuar mes gjithë kandidatëve, kundër mendimit të Geri Kërstit - do të duhej të mësohej, Geri Kërsti nuk e donte, ose mbase e donte tepër a ndoshta ishte xheloz, apo e dëshironte, pak rëndësi ka; do të shfaqej armiqësor në të gjitha rrethanat, pa arsye, në mënyrë të pandreqshme.

Sara i njihte këta burra ambiciozë që urrenin gratë, që ndiheshin të kërcënuar prej tyre, i haste por nuk u kushtonte rëndësi. Ajo çante rrugën e saj, duke i lënë

ata anash. Te *Johnson & Lockwood*, ajo i kishte ngjitur shkallët me shpejtësinë e kalit të lëshuar me galop, duke krijuar një emër të fuqishëm në rrethet e drejtësisë. Gjykata ishte arena e saj, territori i saj, koloseu i saj. Kur hynte aty, ajo shndërrohej në një luftëtare; ishte e fortë, e papërballueshme, e pamëshirshme. Gjatë mbrojtjes, merrte një zë disi ndryshe nga i saj, më i trashë, më solemn. Shprehej me fjali të shkurtra, therëse, prerëse si *uppercuts*. Ajo i nxirrte kundërshtarët e saj *KO*, duke u kapur pas gabimit më të vogël, dobësisë më të vogël të argumentimit të tyre. Ajo i njihte përmendësh çështjet e saj. Nuk e humbte toruan dhe nuk e jepte asnjëherë veten. Që kur kishte filluar si avokate, në studion e vogël në rrugën *Uinston*, e cila e kishte marrë në punë pas diplomës së avokatisë, ajo kishte fituar shumicën dërrmuese të çështjeve të saj. Atë e admironin dhe ia kishin frikën. Në moshën pothuajse dyzet vjeçe, ishte model suksesi për avokatët e brezit të saj.

Në studio qarkullonin zëra se ajo do të ishte *Managing Partner* e ardhshme. Xhonsoni ishte i moshuar, duhej një pasardhës. Vendi ishte i lakmuar nga të gjithë ortakët. Ata kishin filluar të ëndërronin ndërkohë, kalif në krye të vendit. Ky post ishte një ngjitje në majë, një Everest në botën e avokatisë.

Sara kishte gjithçka për ta fituar: një vijimësi shembullore, një vullnet pa të meta, një aftësi për punë që

sfidonte çdo konkurrencë - një formë bulimie që e shtynte gjithmonë të ishte në lëvizje. Ajo ishte një sportive, një alpiniste, që, pas çdo maje, i turrej tjetrës. Kështu e shihte ajo jetën e saj, si një ngjitje të gjatë, duke pyetur ndonjëherë veten se çfarë do të ndodhte kur të ishte në majë. Atë ditë, ajo e priste pa e shpresuar vërtet.

Sigurisht, karriera e saj kishte kërkuar sakrifica. I kishte kushtuar net pa gjumë dhe dy martesat e saj. Edhe pse Sara përsëriste shpesh që burrat duan gra që nuk i lënë në hije ata, ajo pranonte gjithashtu se në dy avokatë bashkë, njëri ishte i tepërt. Ajo kishte lexuar një ditë në një revistë - ajo që pothuaj nuk lexonte kurrë revista - një statistikë mizore për kohëzgjatjen e çifteve të avokatëve. Ia kishte treguar burrit, që kishte në atë kohë, dhe kishin qeshur me këtë - pastaj u ndanë, një vit më pas.

E përpirë nga puna në studio, Sarës i ishte dashur të hiqte dorë nga shumë momente me fëmijët e saj. Mungesa në ekskursionet shkollore, festat e fundit të vitit, spektaklet e kërcimit, ditëlindjet, pushimet, i rëndonte më tepër nga sa donte ta pranonte. Ajo e dinte se gjithë këto momente nuk do të ktheheshin më dhe ky mendim e prekte. E njihte mirë ndjenjën e fajit të nënave që punojnë, e kishte pushtuar që pas lindjes së Hanës, që atë ditë të tmerrshme kur i ishte dashur ta linte, pesëditëshe, në krahët e dados për të zgjidhur një çështje urgjente në studion ku punonte. Ajo kishte kuptuar se, në mjedisin

ku ajo punonte, nuk kishte vend për ankesat e një nëne që ngashërehet. I kishte fshehur lotët nën një shtresë të trashë makijazhi, pastaj kishte shkuar të punonte. Ndihej e shkatërruar, e copëtuar, por nuk mund t'i hapej askujt. E kishte zili lehtësinë e të shoqit, atë lehtësi magjepsëse të burrave të cilët kjo ndjenjë çuditërisht mungonte. Ata kapërcenin derën e shtëpisë me një lehtësi të paturpshme. Duke dalë në mëngjes, ata merrnin me vete vetëm dosjet e tyre, ndërsa ajo tërhiqte kudo peshën e fajit, si një breshkë zhguallin e saj të rëndë. Në fillim ajo ishte përpjekur ta luftonte këtë ndjenjë, ta sprapste, ta mohonte, por nuk ia kishte dalë. E kishte lënë të zinte vend në jetën e saj. Fajësia ishte shoqja e saj e vjetër, që futej kudo pa qenë e ftuar. Ajo qëndronte si një afishe reklame në një fushë, si një puçërr në mes të fytyrës, e pakëndshme, e panevojshme, por ja që kështu ishte: ajo ekzistonte. Duhej jetuar me këtë.

Para vartësve dhe ortakëve, Sara nuk shfaqte asgjë. Ajo kishte si rregull të mos fliste kurrë për fëmijët. Ajo nuk i zinte në gojë, nuk kishte foto të tyre në zyrë. Kur duhej të largohej nga studioja për një vizitë te pediatri ose për ndonjë takim në shkollë, që nuk mund ta shmangte, preferonte të thoshte se kishte *një takim jashtë*. Ajo e dinte se e shihnin me sy më të mirë kur dilte më herët nga puna *për të pirë një gotë* sesa po të fliste për problemet me dadon.

Ia vlente më mirë të gënjeje, shpikje, sajoje, gjithçka, më mirë se të pohoje se kishe fëmijë, me fjalë të tjera: zinxhirë, lidhje, pengesa. Ata ishin si frena për gjendshmërinë, për zhvillimin e karrierës. Sara e mban mend atë gruan, në studion ku punonte më parë, që sapo ishte ngritur në detyrë si ortake, dhe kur kishte njoftuar shtatzëninë e saj, e kishin ulur, i kishin dhënë përsëri statusin e vartëses. Ishte një dhunë e heshtur, e padukshme, një dhunë e rëndomtë që askush nuk e denonconte. Sara kishte nxjerrë mësim për veten saj. Gjatë dy shtatzënieve, ajo nuk u kishte thënë asgjë eprorëve. Çuditërisht, barku i saj kishte mbetur i sheshtë për një kohë të gjatë: deri shtatë muaj afërisht, barra e saj ishte pothuaj e padallueshme, edhe për binjakët, sikur në thellësi të saj, fëmijët e ndienin se nuk duhej të binin në sy. Ishte sekreti i tyre i vogël, një lloj pakti i heshtur mes tyre. Sara kishte marrë lejen e lindjes më të shkurtër të mundshme, ajo ishte kthyer në zyrë dy javë pas operacionit cezarian, në formë të përkryer trupore, me çehre të lodhur, por të grimuar me kujdes, me buzëqeshje të përsosur. Në mëngjes, para se të parkonte veturën poshtë studios, ajo bënte një ndalesë në parkingun e supermarketit aty afër, hiqte ndenjëset e fëmijëve nga pjesa mbrapa dhe i fuste në bagazh për t'i bërë të padukshme. Sigurisht, kolegët e saj e dinin që ajo kishte fëmijë, por ajo kujdesej shumë të mos ua kujtonte. Një sekretare kishte të drejtë të fliste për biberonë dhe dalje dhëmbësh, por jo një ortake.

Sara kishte ndërtuar kështu një mur përsosmërisht hermetik mes jetës së saj profesionale dhe familjare, secila në rrjedhën e vet, si dy drejtëza paralele që nuk takohen. Ishte një mur i brishtë, i pasigurt, që plasaritej ndonjëherë, e që ndoshta do të shembej një ditë.

Pak rëndësi kishte. Ajo donte të mendonte se fëmijët e saj do të ishin krenarë për atë që ajo kishte ndërtuar, dhe për atë që ishte. Ajo përpiqej të kompensonte sasinë e momenteve të kaluara me ta nëpërmjet cilësisë. Në shtëpi, Sara ishte një nënë e dashur dhe e kujdesshme. Për të gjitha të tjerat, ishte Roni, “Roni Magjik”, sikurse e quanin fëmijët. Ai qeshte me këtë nofkë, që ishte bërë pothuaj titull.

Sara e kishte punësuar Ronin disa muaj pas lindjes së binjakëve. Ajo kishte pasur probleme me Lindën, dadon e mëparshme, që, përveç vonesave pafund dhe zellin e pakët për punë, kishte bërë një gabim të rëndë, që i kishte shkaktuar pushimin e menjëhershëm nga puna: Sara, që ishte kthyer një ditë papritur në shtëpi për një dosje që kishte harruar, e gjen Etanin, në atë kohë nëntë muajsh, vetëm në shtratin e tij, në shtëpinë bosh. Linda ishte kthyer nga pazari një orë më pas, sikur të mos kishte ndodhur asgjë, bashkë me Simonin. E kapur në gabim, ajo ishte justifikuar se shëtiste binjakët; një ditë njërin e një ditë tjetrin, duke e gjykuar shumë të vështirë t’i nxirrte të dy bashkë.

Sara e kishte pushuar po atë ditë. Pasi njoftoi në studio se vuante nga shiatiku, ajo kishte intervistuar në ditët në vijim shumë dado, ndër të cilat bënte pjesë dhe Roni. E befasuar që kishte hasur një burrë kandidat për këtë vend pune, ajo në fillim e kishte mënjanuar kandidaturën e tij - çfarë nuk thuhet nëpër gazeta... Për më tepër, duke qenë se dy burrat e saj nuk kishin shkëlqyer në artin e ndërrimit të pelenave apo të dhënies së biberonit, ajo dyshonte kështu në aftësinë e një burri për të shkëlqyer në këtë fushë. Atëherë kishte sjellë ndër mend intervistën e punës te *Johnson & Lockwood*, atë çka i ishte dashur të realizonte, si grua, që t'ia dilte në një mjedis të tillë. Si përfundim, i ishte kthyer përsëri vlerësimit të saj. Roni kishte të drejtë të provonte shansin e tij, si gjithë të tjerët. Ai kishte një CV të përsosur, referenca serioze. Roni kishte dy fëmijë. Banonte në lagjen fqinje. Ishte e qartë se i kishte të gjitha cilësitë e kërkuara për këtë vend pune. Sara e kishte marrë në provë për dy javë, gjatë të cilave Roni ishte treguar i përsosur: ai luante me fëmijët për orë të tëra, gatuante mjeshtërisht, bënte pazarin, punët, larjen e rrobave, duke e lehtësuar nga e gjithë barra e jetës së përditshme. Fëmijët e kishin pëlqyer, edhe binjakët, dhe Hana, pesë vjeçe në atë kohë. Sara sapo ishte ndarë nga burri i dytë, babai i binjakëve, dhe kishte menduar se një figurë mashkullore do të ishte e pëlqyeshme në një familje me një prind, si e saja. Në mënyrë të pavetëdijshme, ajo, duke marrë një burrë si dado, qetësonte veten e saj,

askush nuk do ta zinte vendin e mamit. Pra, Roni ishte bërë “Roni Magjik”, i domosdoshëm për jetën e saj dhe të fëmijëve.

Kur shihej në pasqyre, Sara shikonte një grua dyzetvjeçare që shkëlqen kudo: kishte tre fëmijë të bukur, një shtëpi të mbajtur mirë, në një lagje të pasur, një karrierë që shumëkush ia kishte zili. Ajo ishte imazhi i atyre grave që shohim në revista, të qeshura e të realizuara. Plaga e saj nuk dukej, ishte e padukshme, pothuaj e padallueshme nën makijazhin e përsosur dhe kostumet e stilistëve të njohur.

Megjithatë ajo ekzistonte.

Si mijëra gra në të gjithë vendin, Sara Kohen ishte e ndarë më dysh. Ajo ishte një bombë gati për të shpërthyer.

Smita

Fshati Badlapur, Uttar Pradesh, Indi

Eja këtu.

Lahu.

Mos u vono.

Sot është dita. Nuk duhet të jesh me vonesë.

Në oborrin prapa kasolles, Smita po ndihmon Lalitën të lahet. Vajza e vogël bindet; e urtë, ajo nuk proteston as kur uji i rrjedh në sy. Smita shpleks flokët e saj, që i zbresin deri në bel. Ajo nuk i ka prerë kurrë, kështu është zakoni këtu, gratë i ruajnë për një kohë të gjatë flokët e fëmijërisë, ndonjëherë gjithë jetën. Ajo ia ndan flokët në tri tufa, që i thur me një dorë prej eksperteje për t'i bërë gërshet. Pastaj i zgjat Lalitës sarin që ia ka qepur për net me radhë. Një fqinjë i dhuroi copën. Ajo nuk ka pará të blerë uniformën, që mbajnë nxënësit këtu, por pak rëndësi ka. Vajza e saj do të jetë e bukur për ditën e parë të shkollës, mendon ajo.

Ajo është ngritur me natë për t'i përgatitur bukën - nuk ka mensë, çdo fëmijë e merr drekën me vete. I ka gatuar oriz, ka shtuar pak kërrri, atë që e ruan për raste të veçanta. Ajo shpreson që Lalita do të hajë me oreks ditën e parë të shkollës. Duhet energji për të mësuar shkrim e këndim. Ia vendosi drekën në një kuti të sajuar - një kuti prej hekuri, të pastruar me kujdes, madje edhe e ka zbukuruar. Ajo nuk do që Lalita të ketë turp para të tjerëve. Lalita do të dijë të lexojë, krejt si ata. Si fëmijët e Jatts-ëve.

Vendos pudrën.

Kujdesu për altarin.

Shpejt.

Në dhomën e vetme të kasolles, që shërben njëkohësisht si kuzhinë, si dhomë dhe tempull, Lalita ka për detyrë të pastrojë altarin e vogël kushtuar perëndive. Ajo ndez një qiri dhe e vendos pranë imazheve fetare. Është ajo që tund zilen në fund të lutjeve. Së bashku, Smita dhe vajza e saj recitojnë një lutje për Vishnoun, zoti i jetës dhe krijimit, mbrojtësi i të gjithë njerëzve. Kur rendi i botës prishet, ai mishërohet e zbret në tokë për ta ndrequr, duke marrë herë formën e një peshku, herë të një breshke a të një derri të egër, apo të një njeriu-luan, madje edhe të një njeriu.

Lalitës i pëlqen të ulet mbrëmjeve pranë altarit të vogël, pas darkës, dhe të dëgjojë të ëmën tek i rrëfen

historinë e dhjetë pamjeve të Vishnout. Në mishërimin e tij të parë njerëzor, ai mbrojti kastën e Brahmanëve kundër Kshatriyas, dhe mbushi pesë liqene me gjakun e tyre. Lalita dridhet gjithmonë kur dëgjon këtë tregim. Ajo gjatë lojërave të saj, bën kujdes mos shtypë ndonjë milingonë ose merimangë; ku i dihet, Vishnou është ndoshta aty, fare afër, i mishëruar në një nga këto krijesat e gjora... Një zot në majën e gishtit të saj... Kjo ide i pëlqen dhe e tmerron njëkohësisht. Edhe Nagarajanit i pëlqen në mbrëmje të dëgjojë Smitën pranë altarit. Gruaja e tij është një rrëfimtare e mrekullueshme, ajo që nuk di as të lexojë.

Sot në mëngjes, nuk ka kohë për histori. Nagarajani ka ikur herët, si zakonisht, sapo agon dita. Ai është gjahtar minjsh, si i ati para tij. Ai punon në fushat e Jatts-ëve. Është një traditë shekullore, një mjeshtëri e transmetuar si trashëgimi: arti për të kapur minj me duar. Brejtësit hanë të korrat, dëmtojnë tokat duke gërmuar tunele. Nagarajani ka mësuar t'i dallojë ato vrima të vogla në tokë, aq karakteristike. Duhet të jesh i vëmendshëm, i thoshte i ati. Dhe i duruar. Mos ki frikë. Në fillim, do të të kafshojnë. Do të mësohesh. Ai mban mend kapjen e parë, në moshën tetëvjeçare, kur kishte futur dorën në vrimë. Një dhimbje e rrufeshme i kishte përshkruar mishin, miu kishte kafshuar atë hapësirën e butë mes gishtit të madh dhe treguesit, ku lëkura është shumë e hollë. Nagarajani kishte thirrur dhe kishte nxjerrë dorën

e përgjakur. I ati kishte qeshur. Nuk di ta bësh. Duhet të jesh më i shpejtë, ta kapësh në befasi. Fillo edhe një herë. Nagarajani kishte frikë, kishte mbajtur lotët. Fillo prapë! Ai ishte përpjekur gjashtë herë, gjashtë kafshime, pastaj e kishte nxjerrë miun nga strofulli. I ati e kishte kapur kafshën nga bishti, i kishte përplasur kokën pas një guri, pastaj ia kishte dhënë përsëri të birit. *Ja*, kishte thënë ai thjesht. Nagarajani kishte kapur miun e ngordhur, si një trofe, dhe e kishte çuar në shtëpi.

E ëma në fillim i kishte fashuar dorën. Pastaj kishte pjekur miun. E kishin ngrënë të gjithë bashkë për darkë.

Dalitët si Nagarajani nuk paguhen, ata kanë vetëm të drejtën të mbajnë atë që kapin. Është një formë privilegji: minjtë u përkasin Jatts-ëve, si fushat, dhe gjithçka që gjendet sipër dhe poshtë tyre.

I pjekur, nuk është i keq. Ngjan me pulën, thonë disa. Është pula e të varfërve, e Dalitëve. Mishi i vetëm që kanë ata. Nagarajni tregon që i ati i hante minjtë të tërë, me lëkurën dhe qimet, linte vetëm bishtin, i pangrënshëm. Ngulte kafshën në një shkop, e piqte sipër zjarrit, pastaj e gllabëronte të gjithën. Lalita qesh kur ai tregon këtë histori. Smita preferon t'ia heqë lëkurën. Në mbrëmje ata hanë minjtë, të kapur ditën, me oriz, Smita e ruan ujin e zierjes dhe e shërben si salcë. Ndonjëherë kanë edhe

mbetjet e dhëna nga familjet që u zbraz tualetet, ajo i sjell dhe i ndan me fqinjët.

Bindi-n tënd.

Mos harro.

Lalita kërkon në gjërat e saj dhe nxjerr një shishe të vogël më bojë të kuqe, e kishte gjetur një ditë anës rrugës duke luajtur - nuk kishte guxuar t'i thoshte së ëmës se e kishte vjedhur, në të vërtetë sapo kishte rënë nga çanta e një kalimtareje. Shishja ishte rrokullisur deri në hendek, atje e kishte marrë, duke e shtrënguar si thesar për ta fshehur. E kishte çuar në shtëpi po atë mbrëmje thesarin e saj, kishte thënë se e kishte gjetur, e mbushur nga një ndjesi gëzimi, njëkohësisht dhe turpi. Sikur ta merrte vesh Vishnou...

Smita merr shishen nga duart e së bijës, vizaton në ballin e saj një pikë të kuqe alle. Duhet që rrethi të jetë i përsosur, është një teknikë delikate që kërkon ushtrim. Ajo e prek butësisht bojën me majën e gishtit, pastaj e fikson me pudër. *Bindi*, “syri i tretë”, siç quhet këtu, ruan energjinë dhe rrit përqendrimin. Lalitës do t'i duhet sot, thotë me vete e ëma. Ajo kundron rrethin e vogël mbi ballin e fëmijës dhe buzëqesh. Lalita është e bukur. I ka tiparet fine, sytë e zinj dhe buzën e shkruar si kurorë luleje. Ajo është e bukur me sarin e gjelbër. Smita ndihet

shumë krenare para së bijës shkollare. Ajo vërtet ushqehet me minj, por do të dijë të lexojë, mendon ajo ndërsa i kap dorën dhe e tërheq drejt rrugës kryesore. Do ta ndihmojë të kalojë rrugën, këtu kamionët turren që në mëngjes dhe ecin shpejt, nuk ka sinjalistikë, as vija të bardha.

Ndërsa ecin, Lalita ngre sytë nga e ëma, e shqetësuar: nuk e trembin kamionët, por kjo botë e re, e panjohur nga prindërit e saj, ku ajo duhet të hyjë vetëm. Smita e ndien vështrimin lutës të së bijës; do të ishte kaq e lehtë të kthehej mbrapsht, të merrte shportën prej kulmaku dhe të shkonin të dyja bashkë... Por jo, ajo nuk do ta shohë Lalitën të vjellë anës rrugës. Vajza e saj do të shkojë në shkollë. Ajo do të dijë të lexojë, të shkruajë dhe të numërojë.

Mëso!

Bindu!

Dëgjo mësuesin!

Vajza duket e humbur, papritur kaq e brishtë saqë Smita do të donte ta merrte në krahët e saj dhe të mos e lëshonte kurrë. Ajo duhet të luftojë kundër kësaj ndjenje, ta detyrojë veten. Mësuesi kishte thënë “mirë”, kur Nagarajani shkoi ta takonte. Ai kishte parë rutinë ku Smita kishte futur gjithë kursimet e tyre - monedha të ruajtura me kujdes, për muaj të tërë, për këtë qëllim.

Ai e kishte marrë dhe kishte thënë “mirë”. Smita e di, kështu funksionon gjithçka këtu. Paraja ka forcë bindëse. Nagarajani ishte kthyer me lajmin e mirë për gruan e tij, dhe ata ishin gëzuar.

Ato kalojnë dhe, papritur, tani është momenti t’i lëshojë dorën së bijës në anën tjetër të rrugës. Smita do të donte shumë t’i thoshte: gëzohu, ti nuk do të kesh jetën time, do të kesh shëndet të mirë, nuk do të kollitesh si unë, do të jetosh më mirë dhe më gjatë, do të jesh e respektuar. Nuk do të kesh në lëkurë këtë erë të turpshme, këtë aromë të paheqshme dhe të mallkuar, do të jesh e denjë. Askush nuk do të hedhë mbeturina ushqimi si qen. Ti nuk do ta ulësh kurrë më kokën, as sytë. Smita do të donte shumë t’i thoshte gjithë këtë. Por nuk di si t’ia shprehë, si t’ia thotë së bijës shpresat e saj, ëndrrat e saj pak të çmendura, fluturën që rreh në barkun e saj.

Atëherë ajo përkulet mbi të dhe i thotë vetëm: *Shko*.

Xhulia

Palermo, Sicili

Xhulia zgjohet duke brofur.

Edhe këtë natë ajo ka parë në ëndërr të atin. Fëmijë, asaj i pëlqente aq shumë të shkonte me të atin për mbledhjen e flokëve. Herët në mëngjes, i hipnin të dy *Vespës*, ajo nuk hipte prapa, por para, mbi gjunjët e të atit. Më shumë se gjithçka asaj i pëlqente era që frynte flokët e saj, kjo ndjesi dehëse pafundësie dhe lirie që krijohet nga shpejtësia. Nuk kishte frikë, krahët e të atit e rrethonin, asgjë nuk mund t'i ndodhte. Bërtiste në të tatëpjeta nga kënaqësia dhe emocioni. Ajo vështronte diellin tek ngrihej mbi kodrat e Sicilisë, gumëzhimën që lindte në qendrat urbane, jetën që zgjohet dhe shtriqet.

Më shumë se gjithçka, asaj i pëlqente të trokiste nëpër dyer. Mirëdita, jemi për *cascatura*-n, thoshte ajo gjithë krenari. Gratë i jepnin një ëmbëlsirë ose një figurinë,

duke i besuar trastat me flokët e tyre. Xhulia merrte gjithë krenari mallin që ia zgjaste të atit. Ai nxirrte nga çanta e tij peshoren e vogël prej gize, të cilën e merrte kudo, të trashëguar nga babai dhe gjyshi para tij. Peshonte flokët për t'i vlerësuar me pará dhe i jepte gruas disa monedha. Dikur, flokët shkëmbeheshin me shkrepëse, por me daljen e çakmakëve, tregtia e tyre u shua. Tani paguanin me pará në dorë.

I ati tregonte duke qeshur për ato gratë e moshuara, tepër të lodhura për të dalë nga dhoma, kur lëshonin një litar me një shportë ku ndodheshin flokët e tyre. Ai i përshëndeste me dorë, merrte flokët dhe u linte paratë në shportën që ngjitej lart me të njëjtën mënyrë.

Xhulia e mban mend këtë: të qeshurën e të atit kur i tregonte.

Pastaj ata vazhdonin të dy në shtëpitë e tjera. *Arriverderci!* Te parukierët, malli ishte më i mirë, Xhulias i pëlqente shprehja e fytyrë së të atit kur merrte një gërshet me flokë të gjatë, më të veçantët dhe më të shtrenjtët. Ai i peshonte, i maste, i prekte për të ndier përbërjen dhe dendësinë. Paguante, falënderonte, largohej. Duhej shpejtuar, vetëm në Palermo punishtja Lanfredi kishte njëqind furnizues. Po të nxitonin, do të ishin në shtëpi për drekë.